REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1440/8 prot. Datë 10.07.2025

**V E N D I M**

**Nr. 883/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 10.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, në procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, mallra*", me nr. REF-41770-03-19-2025, me objekt: "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", me fond limit: 36,666,500 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e peseqind) lekë pa TVSH dhe 369,472.99 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH. **Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 19.03.2025, me kurs këmbimi 99.24 (nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e katër) lekë,* zhvilluar me datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

| | |
|---|---|
| **Ankimues:** | BOE "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) me NIPT L42314005A dhe me adresë Rruga "At Zef Pllumbi", pallati nr.16 "Devi 2001", pasuri Nr. 39/118-n10, zona kadastrale 2679, vol 31, Mezez, Tiranë & "KRISTAL 2001" Shpk. |
| **Autoriteti Kontraktor:** | Operatori i Blerjeve të Përqendruara. me adresë Rruga "Reshit Çollaku",Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë). |
| **Baza Ligjore:** | Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*". |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.03.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, mallra"*, me nr. REF-41770-03-19-2025, me objekt: "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", me fond limit: 36,666,500 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 369,472.99 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH. **Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 19.03.2025, me kurs këmbimi 99.24 (nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e katër) lekë,* zhvilluar me datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datë 02.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 23.05.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | OE "ARISA - KONFEKSION" sh.p.k | 29,595,500.00 lekë | I skualifikuar |
| 2. | BOE "GENTIAN SADIKU" sh.p.k & "KRISTAL 2001" Shpk | 34,871,500.00 lekë | I skualifikuar |
| 3. | OE "Bledi Loçi" sh.p.k | 36,584,925.00 lekë | I skualifikuar |

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në datën 26.05.2025 është publikuar "Njoftimi i Anullimit", dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 28 datë 02.06.2025, ku në zbatim të 98 "Anulimi i një procedure prokurimi" të ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar procedura e prokurimit anulohet për arsye se, në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

II.5. Në datën 04.06.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5382 e BOE "Gentian Sadiku" sh.p.k & "KRISTAL 2001" Shpk, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1440/1 prot., datë 05.06.2025 lidhur me skualifikimin e BOE "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1440/2025 prot., datë 04.06.2025.

II.7. Me shkresën përcjellëse me nr. 906/11 prot., datë 17.06.2025, protokolluar me tonë me nr. 1440/2 prot., datë 18.06.2025, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e kërkuar, shoqëruar me dokumentacion mbështetës, ku ka **refuzuar** pretendimet e subjektit ankimues.

II.8. Me shkresën përcjellëse me nr. 2013 prot., datë 30.06.2025, protokolluar me tonë me nr. 1440/3 prot., datë 01.07.2025, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar kërkesë për përshpejtim e shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave.

II.9. Me shkresën përcjellëse me nr. 1440/4 prot., datë 02.07.2025, me lëndë "Kërkesë për dorëzimin e mostrave dhe informacion", Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë institucionit tonë, mostrat e paraqitura (konkretisht për: nr. 4 dhe nr. 21), nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, për të cilat është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, së bashku me dokumentacionin shoqërues, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre (për të gjitha mostrat e dorëzuara nga ankimuesi).

II.10. Me shkresën përcjellëse me nr. 906/14 prot., datë 04.07.2025, protokolluar me tonë me nr. 1440/5 prot., datë 04.07.2025, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin dhe mostrat e kërkuara në shkresën me nr. 1440/4 prot., datë 02.07.2025.

II.11. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në sistemin e ankesave elektronike në kuptim të nenit 113 të LPP-së.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

## Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendim e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre, me

arsyetimin se: *"....[...duhet të disponoje makinerite si më poshtë:-Makina qepëse – minimalisht 15 copë-Makineri hekurosje- minimalisht 1 copë". Referuar Marrëeshjes të Përkohsme të Bashkëpunimit, Antari BOE Gentian Sadiku P.f ka marrë përsipër të prodhojë 26 artikuj të uniformës në masën 15%, duke renditur artikujt dhe sasitë përkatse. Referuar Formularit te Vetdeklarimi rezulton se subjekti Gentian Sadiku P.f nuk disponon makineri qepëse dhe hekurosje. Nisur nga fakti se në Marrëveshjen e Bashkepunimit subjekti Gentian Sadiku P.f ka marrë përsipër 15% të volumit të prodhimit ai detyrimisht duhet të disponpremte makineri qepësë dhe hekurosje në përputhje më përqindjen e volumit të qepjes që ka marrë përsipër, dhe për këtë arsye ai nuk i plotëson kapcitetin teknik mbi makineritë në dispozicion të kërkuar në Kërkesat e Vecanta për Kualifikm......*], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.3. Kapaciteti teknik*

***5.** Operatori ekonomik duhet të disponoje makinerite si më poshtë:*
*-Makina qepëse – minimalisht 15 copë*
*-Makineri hekurosje- minimalisht 1 copë*
<u>*Për makineritë dhe pajisjet e deklaruara sipas kësaj pikë të provohet diponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:*</u>

- *fatura shit blerje* ***ose***
- *kontrata shitblerje* ***ose***
- *kontratë qeraje* ***ose***
- *kontratë huapërdorje.*

<u>**Shënim:**</u> *Kriteri nr. 5 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

III.1.2. Në shtojcën 9 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Pjesa III "Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit" pika B "DEKLARATË "Për disoinimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)", autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

***B: DEKLARATË***

***Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)***

| ***Deklarata*** | ***Përgjigje*** |
|---|---|
| *Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*<br>*Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç* | <u>*Punonjës*</u><br>*Po [ ] Jo [ ]*<br>*Nëse, po, numri i punonjësve:* |

| | |
|---|---|
| *përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.* | *Profili i punonjësve*<br>__________________________________________<br>__<br>*Makineri e mjete*<br>*Po [ ] Jo [ ]*<br>*Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:* |
| ***Emri, Mbiemri*____________**<br>***Firma* _______________________**<br>***Vula*________________**<br>***Data e dorëzimit të deklaratës* _______________** | |

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, në përmbushje të kriterit sa më lart kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 e subjektit "Gentian Sadiku" P.F.;

## B: DEKLARATË

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
| --- | --- |
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | Punonjës<br><br>**Po** [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve: **3**<br><br>Janar 2025 - 3 punonjes<br><br>Shkurt 2025 - 3 punonjes<br><br>Mars 2025 - 3 punonjes<br><br>Profili i punonjësve<br><br>-Administratori<br><br>-Magazinier/**Shofer**<br><br>Edison Kapedani-Ekonomist/**Drejtues Linje**<br><br>Makineri e mjete<br><br>Po [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:<br><br>*1 mjet huaperdorje:* Targa:<br><br>**Kontrate huaperdorje nr Rep: ,Kol: dt 10.07.2024** |
| **Emri, Mbiemri Gentian Sadiku**<br><br>**Firma**____<br><br>**Vula**_____<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës ___02.05.2025_** | |

NIPT: L42314005A JOEL COMPANY GENTIAN SADIKU Tirane - Albania

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 e subjektit "KRISTAL 2001" Shpk;

## B: DEKLARATË

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | <u>Punonjës</u><br><br>**Po** [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>Janar 2025 - 88 punonjes<br><br>Shkurt 2025 - 87 punonjes<br><br>Mars 2025 -86 punonjes<br><br>Profili i punonjësve te nevojshem per kete procedure prokurimi: **17**<br><br>**Nr.** **Emri** **Profesioni**<br><br>1. - Prestare veshjesh<br>2. - Rrobaqepës për qepje<br>3. - Drejtuese Linje<br>4. - Rrobaqepës për qepje<br>5. - Rrobaqepës për qepje<br>6. - Rrobaqepës për qepje<br>7. - Rrobaqepës për qepje<br>8. - Rrobaqepës për qepje<br>9. - Rrobaqepës për qepje<br>10. - Rrobaqepës për qepje<br>11. - Rrobaqepës për qepje<br>12. - Rrobaqepës për qepje |

| | |
|---|---|
| | 13. Rrobaqepës për qepje<br>14. - Rrobaqepës për qepje<br>15. - Rrobaqepës për qepje<br>16. - Rrobaqepës për qepje<br>17. … - Rrobaqepës për qepje<br><u>Makineri e mjete</u><br>Po [ X ] Jo [ ]<br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:<br>**Makineri:**<br>-Makina qepëse –15 copë sipas fatures se importit nr . dt 31.08.2021<br>-Makineri hekurosje- 1 copë sipas fatures se importit me nr dt 10.10.2001 |
| **Emri, Mbiemri Sokol Agalliu**<br>**Firma_**<br>**Vula__**<br>**Data e dorëzimit të deklaratës ___02.05.2025** | KRISTAL 2001 Tiranë |

-Kontratë për marrëveshje për bashkim operatorësh ekonomikë me datë 17.04.2025; **Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre**, ku shoqëria "Gentian Sadiku" PF do të kontribuojë në masë 15 % të volumit të kontratës. "KRISTAL 2001" Shpk do të kontribuojë në masë 85 % të volumit të kontratës. Realizimi i objektit do te kryhet nga te gjithe operatoret sipas ndarjes se mesiperme ne kuptimin e financimit,qe do te jete sipas perqindjes se marre persiper nga secili operator, **ndersa ne realizimin e projektit dhe kryerjes se volumit te puneve per permbushjen e kontrates, ne kete BOE numri i punonjesve, ku kompania"Kristal 2001" Shpk, do te bashkepunoje do te jete me 18 punonjes (1-Stilist/Modelist Veshjesh; 1 Prestar veshjesh;1-Drejtues linje; 15 Rrobaqepes per qepje) per realizimin e kesaj procedure prokurimi,ndersa OE "Gentian Sadiku" P.Fizik do te bashkepunoje me 3 punonjes (1-Shofer, 1-Pergjegjes prodhimi/drejtues linje,1-Inxhinier tekstili,).** Transporti i lendes se pare drejt prodhimit tek kompania "Kristal 2001" shpk si edhe aksesoreve te tyre deri ne krijimin e produktit te gatshem do te mbulohet nga kompania "Gentian Sadiku" P.Fizik. **OE "Kristal 2001" Shpk do te ofroje : -Makina qepëse – 15 copë -Makineri hekurosje- 1 copë te nevojshme per te kryer sherbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri ne realizimin e plote te saj.**

- Deklaratë angazhimi me datë 11.04.2025 e lëshuar nga subjekti "Vojsava Zenelaj" P.F. në cilësinë e subjektit që do të mbështesë subjektin "Gentian Sadiku" P.F. me një inxhinier tekstili dhe subjektin "KRISTAL 2001" Shpk me një stilist veshjesh;

-Shtojcën 9 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik "Vojsava Zenelaj" P.F;

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | Punonjës<br><br>Po [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve: **2**<br><br>Profili i punonjësve qe do te angazhohen ne mbeshtetje te OE: Gentian Sadiku P.Fizik dhe Kristal 2001 Shpk<br><br>1.[redacted] **Stilist Veshjesh**<br><br>2.[redacted] **- Inxhinier tekstili**<br><br>Makineri e mjete<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| **Emri, Mbiemri Vojsava Zenelaj**<br><br>**Firma_**<br><br>**Vula_**<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës ___02.05.2025_** | |

III.1.4. Në neni 2 "*Qëllimi i ligjit*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë*

*pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

***4.** Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.5. Në nenin 82 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*" pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht : *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik."*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.1.6. Në nenin 84 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" përcaktohet se: "*1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues*."

III.1.7. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet se: "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*.

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [1]të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

[1] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[2]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*"

III.1.8. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.9. Në nenin 90 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

*- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*

*- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*

*- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

*- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*

*3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.*

*4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.*

*5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.*

*6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.*

*7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi."*

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet se: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*.

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik"*, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.11. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimuesit, për skualifikimin e BOE ankimuese, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) ankimues, në rastin konkret, nga operatori ekonomik "KRISTAL 2001" SHPK, i cili ka paraqitur

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, dhe nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF, i cili ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e pikës 2.3.5 në kriteret e vecanta të kualifikimit kanë kryer deklarimet si në pikën III.1.3 të këtij vendimi. Gjithashtu, seili anëtar i BOE ankimues, ka deklaruar respektivisht subjektin mbështetës “Vojsava Zenelaj” PF, e cila do të mëbështes me staf teknik - inxhinier tekstili subjektin “Gentian Sadiku” PF dhe me staf teknik-stiliste veshjesh subjektin “KRISTAL 2001” SHPK. Punonjesit e siperpermendur do te jenë të disonueshem per ”Gentian Sadiku” P.Fizik dhe “Kristal 2001” Shpk, duke permbushur kerkesat e Autoritetit Kontraktor perkates deri ne perfundim te kontrates se lidhur midis paleve respektive.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në rastin konkret, kemi një bashkim operatorësh ekonomikë, të cilët kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi më datë 17.04.2025. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “KRISTAL 2001” SHPK do të kontribuojë në masë **85 %** të volumit të kontratës. Anëtari tjetër “Gentian Sadiku” PF do të kontribuojë në masë **15 %** të volumit të kontratës. Sipas nenit 4 “përfaqësimi i kontratës”, subjekti “Gentian Sadiku” PF merr përsipër të jetë përfaqësuese e shoqërive bashëpunuese në të gjitha procedurat e nevojshme për këtë tender. Sipas preventivit të ndarjes së furnizimit të mallit në këtë kontratë, të realizimit dhe kryerjes së volumit të punëve për përmbushjen e saj, Komisioni konstaton se, realizimi i objektit do të kryhet nga të gjithë operatorët sipas ndarjes së mësipërme në kuptimin e financimit, që do të jetë sipas përqindjes së marrë përsipër nga secili operator. Ndërsa, në realizimin e projektit dhe kryerjes së volumit të punëve për përmbushjen e kontratës, OE “Kristal 2001” Shpk do të ofrojë: -Makina qepëse – 15 copë, -Makineri hekurosje- 1 copë, të nevojshme për të kryer shërbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri në realizimin e plotë të saj, ndërsa transporti i lendes se pare drejt prodhimit tek kompania “Kristal 2001” shpk si edhe aksesoreve te tyre deri ne krijimin e produktit te gatshem do te mbulohet nga kompania “Gentian Sadiku” P.Fizik. Duke iu referuar kriterit Operatori ekonomik duhet të disponoje makinerite -Makina qepëse – minimalisht 15 copë; -Makineri hekurosje- minimalisht 1 copë. Për makineritë dhe pajisjet, e deklaruara sipas kësaj pikë, provohet diponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi dhe konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen* ***dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*** Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi

dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen **dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje**. Për më tepër, nenit 4 të kontratës së bashkëpunimit, ku OE "Kristal 2001" Shpk, *[.. ne realizimin e projektit dhe kryerjes se volumit te puneve per permbushjen e kontrates, do të vërë në dispozicion me 18 punonjes (1-Stilist/Modelist Veshjesh; 1 Prestar veshjesh;1-Drejtues linje; 15 Rrobaqepes per qepje) per realizimin e kesaj procedure prokurimi,ndersa OE "Gentian Sadiku" P.Fizik do te bashkepunoje me 3 punonjes (1-Shofer, 1-Pergjegjes prodhimi/drejtues linje,1-Inxhinier tekstili,). Transporti i lendes se pare drejt prodhimit tek kompania "Kristal 2001" shpk si edhe aksesoreve te tyre deri ne krijimin e produktit te gatshem do te mbulohet nga kompania "Gentian Sadiku" P.Fizik.* ***OE "Kristal 2001" Shpk do te ofroje : -Makina qepëse – 15 copë -Makineri hekurosje- 1 copë te nevojshme per te kryer sherbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri ne realizimin e plote te saj...].***

III.1.12. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme, të kërkesave për kualifikim, për disponimin e makinerive si -Makina qepëse – minimalisht 15 copë; -Makineri hekurosje- minimalisht 1 copë, të nevojshme për të kryer shërbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri në realizimin e plotë të saj, të cilat janë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga subjekti "Kristal 2001" Shpk dhe konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit te vetëdeklarimit shtojca 9, për fazën e vlerësimit. Ndërsa, transporti i lëndës së parë drejt prodhimit tek kompania "Kristal 2001" shpk si edhe aksesorëve të tyre deri në krijimin e produktit të gatshëm do të mbulohet nga kompania "Gentian Sadiku" P.Fizik, referuar edhe shërbimit të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, midis palëve. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, në përputhje me natyrën e pjesëmarrjes në furnizimin e mallit objekt prokurimi dhe natyrës së shërbimit, të përcaktuar në aktmarrëveshje, midis palëve.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendim e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre, me arsyetimin se: *"....[...Në pikën 3 Seksioni 2.3. "Kapaciteti Teknik të Këkresave të Vecanat për Kualfikim është kërkuar: Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë*

*staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave; Nr. Profesioni Numri i punonjesve*
*1 Inxhinier tekstili 1*
*2 Stilist/Modelist veshjesh 1*
*3 Pergjegjes prodhimi/drejtues linje 1*
*4 Prestarë veshjesh/teknik prestarie 1*
*5 Rrobaqepës për qepje 15*
*6 Shofer 1 Referuar Marrëeshjes të Përkohshme të Bashkëpunimit, Antari BOE Gentian Sadiku P.f ka marrë përsipër të prodhojë 26 artikuj të uniformës në masën 15%, duke renditur artikujt dhe sasitë përkatse. Referuar Formularit te Vetdeklarimi rezulton se subjekti Gentian Sadiku P.f nuk disponon staf teknik me profilin rrobaqepës. Nisur nga fakti se në Marrëveshjen e Bashkepunimit subjekti Gentian Sadiku ka marrë përsipër 15% të volumit të prodhimit ai detyrimisht duhet të disponojë punonjës rrobaqepës në përputhje me përqindjen e volumit të qepjes që ka marrë përsipër, dhe për këtë arsye ai nuk i plotëson kapcitetin teknik mbi stafin(punonjesit)në dispozicion sipas pikës 3 të Seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik......*], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.3. Kapaciteti teknik*

*3.Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;*

| *Nr.* | *Profesioni* | *Numri i punonjesve* |
|---|---|---|
| *1* | *Inxhinier tekstili* | *1* |
| *2* | *Stilist/Modelist veshjesh* | *1* |
| *3* | *Pergjegjes prodhimi/drejtues linje* | *1* |
| *4* | *Prestarë veshjesh/teknik prestarie* | *1* |
| *5* | *Rrobaqepës për qepje* | *15* |
| *6* | *Shofer* | *1* |

*Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

*a)* *<u>Për inxhinierin e tekstilit te paraqitet:</u>*
*-* *Diplomën, që të vërteton kualifikimin profesional të mësipërm.*
*-* *Kontrate pune e vlefshme*
*-* *Inxhinieri i tekstilit duhet të kenë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.*

*b) <u>Për stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe Pergjegjes prodhimi/drejtues linje te paraqitet për secilin:</u>*

- *Diplome/dëshmi//certifikate kualifikimi profesional*
- *Kontrate pune e vlefshme.*
- *Stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.*

*c) <u>Për rrobaqepesin te paraqitet:</u>*

- *Kontrate pune e vlefshme.*
- *Rrobaqepësi duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.*

*ç) <u>Per punonjesit shofer te paraqitet:</u>*

- *Leje drejtimi mjeti e vlefshme.*
- *Kontrate pune e vlefshme ose kontratë shërbimi.*

- *Listëpagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.*

*<u>Shënim:</u> Duke qenë se mjetet e transportit, të kërkuara në këto dokumente mund të jenë edhe me qera ose në huapërdorje, përveçëse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që punonjësit "Shofer" mund të diponohen edhe me kontraktim.*

*<u>Shënim:</u> Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor**.***

III.2.2. Në shtojcën 9 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Pjesa III "Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit" pika B "DEKLARATË "Për disoinimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)", autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

***B: DEKLARATË***

***Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)***

| ***Deklarata*** | ***Përgjigje*** |
|---|---|
| *Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*<br>*Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç* | *<u>Punonjës</u>*<br>*Po [ ] Jo [ ]*<br>*Nëse, po, numri i punonjësve:* |

<table>
<tr><td>përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</td><td>Profili i punonjësve<br>________________________________________<br>__<br><u>Makineri e mjete</u><br>Po [ ]  Jo [ ]<br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Emri, Mbiemri____________<br>Firma _______________________<br>Vula________________<br>Data e dorëzimit të deklaratës _______________</td></tr>
</table>

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë "Gentian Sadiku" P.F. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, në përmbushje të kriterit sa më lart kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 e subjektit "Gentian Sadiku" P.F.;

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | Punonjës<br><br>**Po** [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve: **3**<br><br>Janar 2025 - 3 punonjes<br><br>Shkurt 2025 - 3 punonjes<br><br>Mars 2025 - 3 punonjes<br><br>Profili i punonjësve<br><br>[illegible]-Administratori<br><br>[illegible]-Magazinier/**Shofer**<br><br>Edison Kapedani-Ekonomist/**Drejtues Linje**<br><br>Makineri e mjete<br><br>Po [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:<br><br>*1 mjet huaperdorje:* Targa: [illegible]<br><br>**Kontrate huaperdorje nr Rep: [illegible],Kol: [illegible] dt 10.07.2024** |

**Emri, Mbiemri Gentian Sadiku**

**Firma____**

**Vula_____**

**Data e dorëzimit të deklaratës ___02.05.2025_**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 e subjektit "KRISTAL 2001" Shpk;

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | <u>Punonjës</u><br><br>**Po** [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>Janar 2025 - 88 punonjes<br><br>Shkurt 2025 - 87 punonjes<br><br>Mars 2025 -86 punonjes<br><br>Profili i punonjësve te nevojshem per kete procedure prokurimi: **17**<br><br>**Nr. Emri Profesioni**<br><br>1. - Prestare veshjesh<br>2. - Rrobaqepës për qepje<br>3. - Drejtuese Linje<br>4. - Rrobaqepës për qepje<br>5. - Rrobaqepës për qepje<br>6. - Rrobaqepës për qepje<br>7. Rrobaqepës për qepje<br>8. - Rrobaqepës për qepje<br>9. - Rrobaqepës për qepje<br>10. - Rrobaqepës për qepje<br>11. - Rrobaqepës për qepje<br>12. - Rrobaqepës për qepje |

| | |
|---|---|
| | 13. Rrobaqepës për qepje<br>14. - Rrobaqepës për qepje<br>15. - Rrobaqepës për qepje<br>16. - Rrobaqepës për qepje<br>17. - Rrobaqepës për qepje<br>Makineri e mjete<br>Po [ X ] Jo [ ]<br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:<br>**Makineri:**<br>-Makina qepëse –15 copë sipas fatures se importit nr . dt 31.08.2021<br>-Makineri hekurosje- 1 copë sipas fatures se importit me nr dt 10.10.2001 |
| **Emri, Mbiemri Sokol Agalliu**<br>**Firma_**<br>**Vula__**<br>**Data e dorëzimit të deklaratës ___02.05.2025** | KRISTAL 2001 Tiranë |

-Kontratë për marrëveshje për bashkim operatorësh ekonomikë me datë 17.04.2025; **Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre**, ku shoqëria "Gentian Sadiku" PF do të kontribuojë në masë 15 % të volumit të kontratës. "KRISTAL 2001" Shpk do të kontribuojë në masë 85 % të volumit të kontratës. Realizimi i objektit do te kryhet nga te gjithe operatoret sipas ndarjes se mesiperme ne kuptimin e financimit,qe do te jete sipas perqindjes se marre persiper nga secili operator, **ndersa ne realizimin e projektit dhe kryerjes se volumit te puneve per permbushjen e kontrates, ne kete BOE numri i punonjesve, ku kompania"Kristal 2001" Shpk, do te bashkepunoje do te jete me 18 punonjes (1-Stilist/Modelist Veshjesh; 1 Prestar veshjesh;1-Drejtues linje; 15 Rrobaqepes per qepje) per realizimin e kesaj procedure prokurimi,ndersa OE "Gentian Sadiku" P.Fizik do te bashkepunoje me 3 punonjes (1-Shofer, 1-Pergjegjes prodhimi/drejtues linje,1-Inxhinier tekstili,).** Transporti i lendes se pare drejt prodhimit tek kompania "Kristal 2001" shpk si edhe aksesoreve te tyre deri ne krijimin e produktit te gatshem do te mbulohet nga kompania "Gentian Sadiku" P.Fizik. **OE "Kristal 2001" Shpk do te ofroje : -Makina qepëse – 15 copë -Makineri hekurosje- 1 copë te nevojshme per te kryer sherbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri ne realizimin e plote te saj.**

- Deklaratë angazhimi me datë 11.04.2025 e lëshuar nga subjekti "Vojsava Zenelaj" P.F. në cilësinë e subjektit që do të mbështesë subjektin "Gentian Sadiku" P.F. me një inxhinier tekstili dhe subjektin "KRISTAL 2001" Shpk me një stilist veshjesh;

-Shtojcën 9 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” P.F;

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | Punonjës<br><br>Po [ **X** ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve: **2**<br><br>Profili i punonjësve qe do te angazhohen ne mbeshtetje te OE: Gentian Sadiku P.Fizik dhe Kristal 2001 Shpk<br><br>1.[redacted] **Stilist Veshjesh**<br><br>2.[redacted] **- Inxhinier tekstili**<br><br>Makineri e mjete<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| **Emri, Mbiemri Vojsava Zenelaj**<br><br>**Firma_**<br><br>**Vula_**<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës ___02.05.2025_** | VOJSAVA ZENELAJ<br>Shtëpia e Modës<br>NUIS: L12330004A<br>Mob: 067 41 37 819 |

III.2.4. Në neni 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik”* parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

***4.** Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.2.5. Në nenin 82 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*" pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht : *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të*

*vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik."*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.2.6. Në nenin 84 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" përcaktohet se: "*1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues*."

III.2.7. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet se: "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*.

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve* [3]*të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

[3] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[4]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*"

III.2.8. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.2.9. Në nenin 90 “*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“*1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

*- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*

*- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*

*- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

*- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*

*3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.*

*4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.*

*5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.*

*6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.*

*7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi."*

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet se: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në <u>përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje</u>.*

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik"*, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.11. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimuesit, për skualifikimin e BOE ankimuese, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) ankimues, në rastin konkret, nga operatori ekonomik "KRISTAL 2001" SHPK, i cili ka paraqitur

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, dhe nga operatori ekonomik "Gentian Sadiku" PF, i cili ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e pikës 2.3.3 në kriteret e vecanta të kualifikimit kanë kryer deklarimet si në pikën III.2.3 të këtij vendimi. Gjithashtu, secili anëtar i BOE ankimues, ka deklaruar respektivisht subjektin mbështetës "Vojsava Zenelaj" PF, e cila do të mëbështes me staf teknik - inxhinier tekstili, subjektin "Gentian Sadiku" PF dhe me staf teknik-stiliste veshjesh, subjektin "KRISTAL 2001" SHPK. Punonjësit e sipërpërmendur do të jenë të disonueshem për "Gentian Sadiku" P.Fizik dhe "Kristal 2001" Shpk, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor përkatës deri në përfundim të kontratës së lidhur midis palëve respektive.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në rastin konkret, kemi një bashkim operatorësh ekonomikë, të cilët kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi më datë 17.04.2025. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria "KRISTAL 2001" SHPK do të kontribuojë në masë **85 %** të volumit të kontratës. Anëtari tjetër "Gentian Sadiku" PF do të kontribuojë në masë **15 %** të volumit të kontratës. Sipas nenit 4 "përfaqësimi i kontratës", subjekti "Gentian Sadiku" PF merr përsipër të jetë përfaqësuese e shoqërive bashëpunuese në të gjitha procedurat e nevojshme për këtë tender. Sipas preventivit të ndarjes së furnizimit të mallit në këtë kontratë, të realizimit dhe kryerjes së volumit të punëve për përmbushjen e saj, Komisioni konstaton se, realizimi i objektit do të kryhet nga të dy subjektet, sipas ndarjes së mësipërme në kuptimin e financimit, që do të jetë sipas përqindjes së marrë përsipër nga secili operator. Në këtë BOE, numri i punonjësve, ku kompania "Kristal 2001" Shpk, do të vërë në dispozicion 18 punonjës (1-Stilist/Modelist Veshjesh; 1-Prestar veshjesh; 1-Drejtues linje; 15-Rrobaqepes për qepje) për realizimin e kësaj procedure prokurimi, ndërsa OE "Gentian Sadiku" P.Fizik do të verë në dispozicion 3 punonjës (1-Shofer, 1-Përgjegjës prodhimi/drejtues linje, 1-Inxhinier tekstili,) Duke iu referuar kriterit 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponoje staf teknik me kualifikime dhe të figurojën në listpagesa për 3 muajt e fundit, 1-inxhinier tekstili; 1- Stilist/Modelist veshjesh; 1-Pergjegjes prodhimi/drejtues linje; 1- Prestarë veshjesh/teknik prestarie; 15- Rrobaqepës për qepje dhe 1- Shofer. Për stafin teknik, të deklaruar sipas kësaj pikë, konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen* ***dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*** Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe

kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen **dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje**. Për më tepër, nenit 4 të kontratës së bashkëpunimit, ***ku OE "Kristal 2001" Shpk, [.. ne realizimin e projektit dhe kryerjes se volumit te puneve per permbushjen e kontrates, do të vërë në dispozicion me 18 punonjes (1-Stilist/Modelist Veshjesh; 1 Prestar veshjesh;1-Drejtues linje; 15 Rrobaqepes per qepje) per realizimin e kesaj procedure prokurimi,ndersa OE "Gentian Sadiku" P.Fizik do te bashkepunoje me 3 punonjes (1-Shofer, 1-Pergjegjes prodhimi/drejtues linje,1-Inxhinier tekstili***,). *Transporti i lendes se pare drejt prodhimit tek kompania "Kristal 2001" shpk si edhe aksesoreve te tyre deri ne krijimin e produktit te gatshem do te mbulohet nga kompania "Gentian Sadiku" P.Fizik. OE "Kristal 2001" Shpk do te ofroje : -Makina qepëse – 15 copë -Makineri hekurosje- 1 copë te nevojshme per te kryer sherbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri ne realizimin e plote te saj...].* Gjithashtu, secili anëtar i BOE ankimues, ka deklaruar respektivisht subjektin mbështetës "Vojsava Zenelaj" PF, e cila do të mëbështes me staf teknik -inxhinier tekstili, subjektin "Gentian Sadiku" PF dhe me staf teknik-stiliste veshjesh, subjektin "KRISTAL 2001" SHPK. Punonjësit e sipërpërmendur do të jenë të disonueshem për "Gentian Sadiku" P.Fizik dhe "Kristal 2001" Shpk, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor përkatës deri në përfundim të kontratës së lidhur midis palëve respektive.

III.2.12. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme, të kërkesave për kualifikim, për disponimin e stafit teknik me kualifikime dhe të figurojën në listpagesa për 3 muajt e fundit, 1-inxhinier tekstili; 1- Stilist/Modelist veshjesh; 1-Pergjegjes prodhimi/drejtues linje; 1- Prestarë veshjesh/teknik prestarie; 15- Rrobaqepës për qepje dhe 1- Shofer. Për stafin teknik, të deklaruar sipas kësaj pikë, konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9, të nevojshme për të kryer shërbimin e qepjes dhe hekurosjes, deri në realizimin e plotë të saj, të cilat janë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga subjekti "Kristal 2001" Shpk dhe konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit te vetëdeklarimit shtojca 9, për fazën e vlerësimit. Ndërsa, transporti i lëndës së parë drejt prodhimit tek kompania "Kristal 2001" shpk si edhe aksesorëve të tyre deri në krijimin e produktit të gatshëm do të mbulohet nga kompania "Gentian Sadiku" P.Fizik, referuar edhe shërbimit të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, midis palëve. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.3. të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, në përputhje me natyrën e

pjesëmarrjes në furnizimin e mallit objekt prokurimi dhe natyrës së shërbimit, të përcaktuar në aktmarrëveshje, midis palëve.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendim e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Gentian Sadiku" P.Fizik. (përfaqësues) & "KRISTAL 2001" Shpk, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre, me arsyetimin se: *"....[...I)Për mostrën e arikujve Nr.21 Kostum dimëror (xhup, pantallona dhe kapele sportive dimërore) dhe Nr.4"Xhakovento" për punonjësit e Gardës të Republikës, rezulton se nuk është zbatuar kërkesa Autoritetit Kontraktor: "Mostrave u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë ne të cilën shkruhet: moster "Kostum uniforme", emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit", pasi për këto mostra nuk janë qepur etiketa me tekstil të bardhë por janë paraqitur një etiketë letre, e paqepur e kapur me kapse aktesh. Përvec kësaj mangësie, etiketat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesën e AK, pasi për cdo moster te produktit dhe lëndës së parë, mungon vula subjektit që i ka prodhuar këto mostra që është antari tjetër i BOE "KRISTAL 2001" sh.p.k. Këto etiketa mbajnë vulën e subjektit Gentian Sadiku P.F ndërkohë që duhet të mbanin detyrimisht vulën e të dy antarëve të BOE në cilësinë e ofertuesit. II) BOE ("GENTIAN SADIKU" Person fizik, dhe "KRISTAL 2001", referuar procesverbalit të pranimit të mostrave nuk dorëzoi mostrën për artikullin 'Këmishë me mëngë të shkurtra"*.......], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Referuar dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.3. Kapaciteti teknik*

***4.*** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë: i. mostrat e artikujve, ii. mostrat e lëndës së parë dhe iii. fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtejonë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Fletë analiza do të paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.*

*Mostrat e artikujve, lëndës së parë dhe fletë analizat do të paraqiten për artikujt si më poshtë:*

***4."Xhakovento" për punonjësit e Gardës të Republikës.***

*- 1 (një) copë "Xhakovento" me nr gjoksi 50.*

*- 1 (një) pjesë stof gjatësi 0,5 ml.*

*- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.*

*Copa e Xhakoventos moster, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njejta.*

*Xhakoventos dhe lendes së parë, u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të peraferta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster "Xhakovento" emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.*

***Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.***

***5. "Këmishë me mëngë të shkurtra" për punonjësit e Gardës së Republikës***

*- 1 (një) copë **"**Këmishë me mëngë të shkurta**"** me nr gjoksi 50.*

*- 1 (një) pjesë pupline gjatësi 0,5 ml, gjërësi sa ajo e vet puplinës.*

*- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.*

*Copa e Këmishës moster, lëndës së parë (pjesë puplinë) dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.*

*Këmishës dhe lëndës së parë u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili i bardhë, me permasa të përaferta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster "Këmishë me mëngë të shkurta uniforme Garde", emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.*

***Mungesa e mostrës, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.***

***21**. **Kostum dimëror (**xhup, pantallona dhe kapele sportive dimërore **)** për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.*

*- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (xhup, pantallota dhe kapele sportive dimërore) me nr gjoksi 50.*
*- 1 (një) pjesë tekstili 50 x50 cm.*
*- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi.*
*Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.*
*Kostumit dhe lendes së parë u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster "Kostum dimëror policía rrugore", emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.*
***Mungesa e mostrës, lëndës së parë dhe fletë analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.***

III.3.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 906/14 prot., datë 04.07.2025, protokolluar me tonë me nr. 1440/5 prot., datë 04.07.2025, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin dhe mostrat e kërkuara në shkresën me nr. 1440/4 prot., datë 02.07.2025, nga ku rezulton, se subjekti ankimues BOE, ka paraqitur pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Mostër për artikullin nr. 4, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor, 1 (një) copë dhe 1 (një) pjesë tekstili;
-Mostër për artikullin nr. 21, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor, ku përfshihet xhup 1 (një) copë, pantallona 1 (një) palë, kapele sportive 2 (dy) copë dhe 1 (një) pjesë tekstili.
-Procesverbal datë 02.05.2025 me objekt "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", "Mbi dorëzimin dhe evidentimin fizik të kampionëve/modeleve të ofertës teknike, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës", i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si dhe përfaqësues i subejktit "Gentian Sadiku" P.Fizik, administratori.

III.3.3. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit nr.162/2022 *"Për Prokurimin Publik"* parashikohet se:
*Qëllim i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr.162/2022 *"Për Prokurimin Publik"* parashikon se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.3.4. Në pikën 6 të nenit 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"6.Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet,*

*mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b)fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c)dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike."*

III.3.5. Udhëzimit nr. 03, datë 12.04.2022 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë" pika 3 parashikon se: *"Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi. Në këtë kuptim, në rast kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe orën e përcaktuar në dokumentat e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal,. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara. Në këtë rast, mbajtja eprocesvrbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit. Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkrihet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t'i vihet në dispozicion ofertuesit/ve. Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur".*

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.
KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e BOE ankimues, ka të bëjë përkatësisht me skualifkimin e BOE për mospërmbushjen e kriterit të vecantë të kualifikimit pika 2.3.4 për artikujt me nr. 4 dhe nr.21 si dhe mungesës së dorëzimit të mostrës për artikullin me nr. 5. Duke iu referuar kriterit në pikën 2.3.4, autoriteti kontraktor ka kërkuar *i. mostrat e artikujve, ii. mostrat e lëndës së parë dhe iii. fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtejonë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Fletë analiza do të paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.* Mostrës dhe lëndës së parë, u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster "xxxx", emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.
Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.
Për plotësimin e këtij kriteri vlerësimi, BOE ankimues, ka dorëzuar:

-Mostër për artikullin nr. 4, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor, 1 (një) copë dhe 1 (një) pjesë tekstili;
-Mostër për artikullin nr. 21, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor, ku përfshihet xhup 1 (një) copë, pantallona 1 (një) palë, kapele sportive 2 (dy) copë dhe 1 (një) pjesë tekstili.

Për të vlërsuar dhe gjykuar mbi këtë ritr të vecantë kualifikimi, KPP i kërkoi autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, të dërgojë mostrat e paraqitura nga BOE për artukujt me nr. 4 dhe 21, së bashku me dokumentacionin shoqërues, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre. Me shkresën përcjellëse me nr. 906/14 prot., datë 04.07.2025, protokolluar me tonë me nr. 1440/5 prot., datë 04.07.2025, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin dhe mostrat e kërkuara në shkresën me nr. 1440/4 prot., datë 02.07.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi mostrat e paraqitura nga BOE ofertues, së bashku me dokumentacionin shoqërues, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre.
Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, Komisioni konstatoi se, BOE ankimues, ka dorëzuar më anë të një procesverbali të datës datë 02.05.2025 me objekt "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", "Mbi dorëzimin dhe evidentimin fizik të kampionëve/modeleve të ofertës teknike, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës", i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si dhe përfaqësues i subejktit "Gentian Sadiku" P.Fizik, administratori, Mostër për artikullin nr. 4, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor, 1 (një) copë dhe 1 (një) pjesë tekstili dhe Mostër për artikullin nr. 21, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor, ku përfshihet xhup 1 (një) copë, pantallona 1 (një) palë, kapele sportive 2 (dy) copë dhe 1 (një) pjesë tekstili. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në zbatim të Udhëzimit nr. 03, datë 12.04.2022 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë" i cili parashikon se *Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara,* ka mbajtur Proces-verbal datë 02.05.2025 me objekt "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", "Mbi dorëzimin dhe evidentimin fizik të kampionëve/modeleve të ofertës teknike, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës", i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si dhe përfaqësues i subjektit "Gentian Sadiku" P.Fizik., për dorëzimin e tyre (mostrat për artikujt me nr. 4 + me nr.21). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në rastin konkret, kemi një bashkim operatorësh ekonomikë, të cilët kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi më datë 17.04.2025. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria "KRISTAL 2001" SHPK do të kontribuojë në masë **85 %** të volumit të kontratës. Anëtari tjetër "Gentian Sadiku" PF do të kontribuojë në masë **15 %** të volumit të kontratës. ***Sipas nenit 4 "përfaqësimi i kontratës", subjekti "Gentian Sadiku" PF merr përsipër të jetë përfaqësuese e shoqërive bashëpunuese në të gjitha procedurat e nevojshme për këtë tender***. Nga verifikimi i këtyrë mostrave, Komisioni konstaton se në zbatim të kërkesë së autoriteti kontraktor, ofertuesi BOE ka dorëzuar mostrat me nr. 4 dhe me nr. 21, ku lëndës së parë të mostrave, i është qepur me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: mostër "Xhakovento" për artikullin nr. 4 dhe mostër "Kostum

dimëror", emri i ofertuesit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit, ku në rastin konkret, është ajo e subjektit përfaqësues "Gentian Sadiku" PF, i cili është edhe përfaqësuesi i BOE sipas nenit 4 të akt-marrëveshjes. Për sa më sipër sqaruar, Komisioni do të konsiderojë të vlefshme dhe në plotësim të kriterit 2.3.4 dorëzimin e mostrave për artikujt me nr.4 dhe me nr. 21 nga ana e BOE.
Gjithashtu, në lidhje me arsyen tjetër të skualifikimit për mungesë fizike të dorëzimit të mostrës me nr. 5 "*Këmishë me mëngë të shkurtra",* Komisioni konstaton se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka mbajtur Proces-verbal datë 02.05.2025 me objekt "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", "Mbi dorëzimin dhe evidentimin fizik të kampionëve/modeleve të ofertës teknike, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës", i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si dhe përfaqësues i subjektit "Gentian Sadiku" P.Fizik., për dorëzimin e tyre (mostrat për artikujt me nr. 4 + me nr.21+ nr. 5), ku merret informacion se është dorëzuar mostër për artikullin me nr. 5 "*Këmishë me mëngë të shkurtra",* ku Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka cituar se është dorëzuar për artikullin me nr.5, këmishë me mëngë të gjata. Në këtë rast, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, e cila nuk ka qenë prezent në datën dhe orën e dorëizmit të mostrave nga përfaqësuesi i BOE ankimuese, nuk i është referuar procesverbalit të mbajtur me datë 02.05.2025 me objekt "*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*", "Mbi dorëzimin dhe evidentimin fizik të kampionëve/modeleve të ofertës teknike, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës", i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si dhe përfaqësues i subjektit "Gentian Sadiku" P.Fizik., për dorëzimin e tyre, ku evidentohet dorëizmi dhe pranimi i mostrës për artikullin nr. 5, të nënshkruar nga plaët që kanë qenë prezent. Për sa më sipër sqaruar, Komisioni do të konsiderojë të vlefshme dhe në plotësim të kriterit 2.3.4 dorëzimin e mostrëse për artikullin me nr.5. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis.*

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shpk për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, mallra*”, me nr. REF-41770-03-19-2025, me objekt: “*Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës*”, me fond limit: 36,666,500 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 369,472.99 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH. **Shënim: Vlerat në Lekë në këto dokumente tenderi janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 19.03.2025, me kurs këmbimi 99.24 (nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e katër) lekë,* zhvilluar me datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shp, të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke ekualifikuar këtë BOE, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Gentian Sadiku” P.F. (përfaqësues) & “KRISTAL 2001” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2025.07.14
11:22:49

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2025/07/11 12:22:22 +02'00'
8677fea3c89a4adfb9a50dd3b046fe622025071112221488020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*